

STATUTI DHE AKTI I THEMELIMIT
I
SHOQËRISË TREGTARE ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR
“ORTECH” SHPK

Ky statut dhe akt i themelimit, Ligji nr. 9901, datë 14.04.2008, “Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare” (i ndryshuar), Ligji Nr. 9723 “Për Regjistrimin e Biznesit”, i ndryshuar, rregullojnë organizimin dhe funksionimin e shoqërisë tregtare me përgjegjësi të kufizuar “ORTECH” SHPK.

KREU I

Emri, Forma, Zyra Qendrore, Objekti i Veprimitarisë, Kohëzgjatja, Degët dhe Zyrat e Përfaqësimit, Përgjegjësia e Ortakut

NENI 1

Emri

1.1 Shoqëria tregtare mban emrin “ORTECH” SHPK.

1.2 Ndryshimi i emërtimit të shoqërisë mund të bëhet vetëm me vendim të Ortakëve të shoqërisë.

NENI 2

Forma

2.1 Shoqëria tregtare “ORTECH” SHPK, ka formën e një shoqërie me përgjegjësi të kufizuar.

NENI 3

Zyra Qendrore

3.1 Shoqëria tregtare me përgjegjësi të kufizuar “ORTECH” SHPK, do të ketë zyrën e saj qendrore në Shqipëri, Tiranë, Rruga “Myslym Shyri” Tiranë, Pallati Matrix, Hyrja 1, Kati 1, Ap 3, Kodi Postar 1001. Adresë emaili info@ortech.com

NENI 4

Objekti i Veprimitarisë

4.1 Shoqëria ka për objekt veprimitaritë e mëposhtme:

- Shërbime në fushën e teknologjisë së informacionit dhe komunikimit (TIK).
- Konsulencë dhe menaxhim të projekteve. Dizenjim, implementim dhe mirëmbajtje të sistemeve.
- Shërbime në fushën e sigurisë kibernetike dhe auditimi të sistemeve, hostim infrastrukture dhe software, hostim i bazës së të dhënave, hedhje dhe përpunim të dhëash.
- Projektim, zhvillim, implementim, testim dhe mirëmbajtje të platformave dhe sistemeve software e hardware, që përfshihen në aktivitete ICT, në të gjitha fushat e aktivitetit të biznesit, të menaxhimit, qeverisjes, prodhimit dhe cdo fushe tjeter aktiviteti ekonomik e shoqëror që kërkon mbështetje nga procese dhe sisteme ICT, përfshirë ato në fushën e administrimit të aktiviteve të biznesit, në fushën e edukimit dhe të zgjidhjeve interaktive multimediale, në fushat e punimeve

topogeodezike, gjeodezi inxhinierike, hartografi, fotogrametri, sistemet e informacioneve gjeografike (GIS), pasurite e paluajtshme, në fushën e biznesit finansiar e bankar, në atë të shërbimeve të sigurimit të jetës, shëndetit e pasurisë, etj.

- Kurse të formimit profesional për platformat software për nivele të ndryshme (analist, përdorues, zhvillues, trajnues, etj.). Kurse të formimit profesional për sisteme ICT, aplikacione, menaxhim projektesh, menaxhim procesesh dhe cilësie. Dizenjimi grafik, zhvillim dhe mirëmbajtje e faqeve web. Sisteme monitorimi video. Sisteme dhe pajisje ICT të karakterit industrial dhe për nevoja specifike të projekteve të rëndësishë së vecantë.
- Import-eksport, dizenjim, prodhim, asemblim dhe aktivitet i tregtimit me shumicë e pakicë i pajisjeve të telekomunikacionit, informatikës, elektronikës, rrjetave kompjuterike, telefonisë, pajisjeve të fuqisë, pajisjeve të sistemeve të sigurisë dhe akses kontrollit, kamerave, sistemeve video dhe audio, pajisjeve të transmetimit pa valë, kabllove të bakrit dhe kabllove optike. Import-eksport, shitje, implementim, integrim dhe mirëmbajtje e produkteve software apo shërbimeve të suportit të palëve të treta në trajtën e licensave software apo blerjes së shërbimeve periodike.
- Shërbime suporti teknik, shitje e marketing për palë të treta. Projektim, ndërtim e mirëmbajtje qendrash të dhënash (data center), përfshirë të gjithë elementët pasivë e aktivë të saj (sisteme, pajisje, software dhe elementë të tjera). Shërbime për data center dhe cloud.
- Operator i shërbimeve të telekomunikacionit per perdoruesit biznes dhe familjare: Ndertim Rrjetash publike dhe private (aksesi apo transmetimi) te komunikimeve elektronike tokesore fikse (me percjelesa metalike, me fiber optike) ose me radio(ëireless).
- Shërbime publike të komunikimeve elektronike (shërbimi i aksesit në Internet, transmetimit të të dhënave).
- Organizimi dhe zbatimi i fushatave promovuese, eveneteve dhe evenimenteve të çdo lloji:
 - o Veprimtari marketingu, promocioni dhe distribucioni për të gjitha llojet e shërbimeve dhe mallrave për llogari të vetat, ose në funksion të të tretëve
 - o Konceptimi, organizimi dhe manazhimi i reklamave të fushatave, eveneteve, fushatave të marketingut, të marrëdhënieve me publikun spoteve publicitare, në fushën e design-it, publikimeve, reklamave dhe promocionit

Shoqëria mund të kryejë çdo veprim që do të ketë lidhje me hapjen e degëve, të punësojë stafin teknik, të diplomuar, të blejë, shesë, të japë me qira dhe shkëmbujë pasuri të paluajtshme, të luajtshme, makineri, pajisje dhe materiale; të marrë dhe të japë me qera pasuri të paluajtshme dhe të luajtshme, të ndërmarrë veprime financiare, të marrë kredi me ose pa garanci hipotekore të pasurive, të përfitojë grante financiare dhe private; të marri dhe të japi pjesë dhe interesa në ndërmarrje dhe shoqëri të tjera, si dhe të kryejë të gjitha aktivitetet e lidhura, të nevojshme për realizimin e objektit të veprimtarisë së saj.

NENI 5
Kohëzgjatja

5.1 Kohëzgjatja e aktivitetit të shoqërisë “ORTECH” SHPK do të jetë për një periudhë kohore të pacaktuar duke filluar nga data e regjistrimit në QKB.

NENI 6
Degët dhe Zyrat e Përfaqësimit

6.1 Shoqëria tregtare “ORTECH” SHPK mund të hapë degë të saj ose zyra përfaqësimi brenda ose jashtë vendit.

6.2 Mbledhja e Ortakëve, mund të vendosë, transferojë dhe/ose të mbyllë, si brenda edhe jashtë shtetit shqiptar, degë sekondare, filiale, seli, agjensi, zyra përfaqësimi dhe bashkësi lokale të çdo natyre.

NENI 7
Përgjegjësia e Ortakut

7.1 Ortakët përgjigjen për detyrimet e shoqërisë “ORTECH” SHPK dhe mbulojnë personalisht humbjet e shoqërisë deri në pjesën e pashlyer të kontributeve të nënshkruara prej tyre.

KREU II
Kapitali i Regjistruar dhe Kuotat, Zmadhimi dhe Zvogëlimi i Kapitalit, Kalimi i Kuotave të Kapitalit

NENI 8
Kapitali i Shoqërisë dhe Kuotat

8.1 Kapitali i regjistruar i shoqërisë me përgjegjësi të kufizuar “ORTECH” SHPK është 10.000 (dhjetë mijë) lekë. Kapital i nënshkruar dhe i shlyer tërësisht nga të dy ortakët e shoqërisë.

8.2 Ortakët e shoqërisë janë:

- **zpj. Marjola Xhelili**, atësia Ferdinand lindur në Gramsh, Shqipëri, më 08.08.1978 me numër dokumenti BF9750296, është zotëruar i 1 (një) kuote me vlerë 5.000 (pesë mijë) lekë e cila përbën 50% të kapitalit të shoqërisë.

- **zpj. Ada Ilia**, atësia Anesti, lindur në Tiranë, më datë 06.05.1983, me numër identifikimi I35506061B, është zotëruar i 1 (një) kuote me vlerë 5.000 (pesë mijë) lekë e cila përbën 50% të kapitalit të shoqërisë.

3 | F a q e

NENI 9
Zmadhimi dhe Zvogëlimi i Kapitalit të Regjistruar

9.1 Kapitali i regjistruar i shoqërisë mund të zmadhohet pa kufi, një ose disa herë, me vendim të dy Ortakëve të Vetëm, në përputhje me dispozitat ligjore në fuqi.

9.2 Kapitali i regjistruar i shoqërisë mund të zvogëlohet me vendim të dy Ortakëve të Shoqërisë. Në çdo rast, kapitali i regjistruar i shoqërisë nuk mund të zvogëlohet nën minimumin e kërkuar nga ligji.

NENI 10
Kalimi i Kuotave të Kapitalit të Regjistruar

10.1 Kuota e kapitalit është lirisht e transferueshme.

10.2 Kalimi i kuotës bëhet me vendim të Ortakëve të Shoqërisë ose edhe vetëm nëpërmjet nënshkrimit të kontratës së shitjes së kuotës, pa qenë nevoja e marrjes së një vendimi paraprak nga Ortakët e shoqërisë.

10.3 Kuota mund të pjesëtohet për shkak të kalimit.

10.4 Kuota e kapitalit është lirisht e transferueshme në rrugë trashëgimie.

KREU III
Organet e Shoqërisë, Punësimet në Shoqëri

NENI 11
Asamblea e Përgjithshme
(Ortakët e Shoqërisë)

11.1 Organi vendimmarrës i shoqërisë është Asambleja e Përgjithshme (Ortakët e Shoqërisë).

NENI 12
Të Drejtat dhe Detyrimet e Asamblesë së Përgjithshme (Ortakët e Shoqërisë)

12.1 Asambleja e Përgjithshme (Ortakët e Shoqërisë) merr vendime për shoqërinë në lidhje me çështjet e mëposhtme:

- përcaktimin e politikave tregtare të shoqërisë;
- ndryshimet e statutit;
- emërimin dhe shkarkimin e administratorëve;
- emërimin dhe shkarkimin e likuiduesve dhe të ekspertëve kontabël të regjistruar;
- përcaktimin e shpërblimeve, për administratorët, likuiduesit dhe ekspertët kontabël të regjistruar;
- mbikëqyrjen e zbatimit të politikave tregtare nga administratorët, përfshi përgatitjen e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë së veprimtarisë;

- miratimin e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë së veprimtarisë;
- zmadhimin dhe zvogëlimin e kapitalit;
- pjesëtimin e kuotës;
- përfaqësimin e shoqërisë në gjykatë dhe në procedimet e tjera ndaj administratorëve;
- riorganizimin dhe prishjen e shoqërisë;
- shpërndarjen e fitimeve vjetore dhe mbulimin e humbjeve;
- vendos për pagat e punonjësve dhe dhënien e shpërblimeve përkatëse;
- të gjitha çështjet e tjera të cilat parashikohen në ligji dhe nuk i janë deleguar Administratorit të Shoqërisë.

NENI 13

Mbledhja e Asamblesë së Përgjithshme (Ortakët e Shoqërisë)

13.1 Për thirrjen dhe mbledhjen e Asamblesë së Përgjithshme (Ortakët e Shoqërisë) do të zbatohen dispozitat ligjore në fuqi dhe konkretisht Ligji Nr. 9901, datë 14.04.2008 “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtarë”.

13.2 Vendimet e marra nga Ortakët, së bashku me procesverbalin e mbledhjes dhe aktet e tjera që i bashkëlidhen sipas ligjit këtij procesverbalit, regjistrohen në librin e shoqërisë.

NENI 14

Administratori

14.1 Administratori është organi ekzekutiv i shoqërisë.

14.2 Shoqëria administrohet nga një administrator që emërohet dhe shkarkohet nga Asambleja e Përgjithshme. Afati i emërimit është 5 vjet me të drejtë ripërtëritje.

14.3 Administratori ka të drejtë të kryejë administrimin e zakonshëm të shoqërisë. Ai/Ajo ka të drejtë të:

- përfaqësojë shoqërinë pranë çdo organi shtetëror si dhe në marrëdhënie me të tretët;
- të hartojë dhe të nënshkruajë çdo dokument të nevojshëm lidhur me mbarëvajtjen e aktivitetit të shoqërisë si dhe ti depozitojë ato pranë çdo organi kompetent shtetëror, apo personave të tretë privatë, në përputhje me legjislacionin shqiptar në fuqi.
- të kujdeset për mbarëvajtjen e punëve të përditshme të shoqërisë, duke kryer të gjitha veprimet e nevojshme lidhur me mbikëqyrjen e personelit, punësimin dhe pushimet nga puna të personelit;
- të kujdeset për mbajtjen e saktë e të rregullt të dokumenteve dhe të librave kontabël të shoqërisë;
- të përgatisi dhe nënshkruaj bilancin vjetor, bilancin e konsoliduar dhe raportin e ecurisë së veprimtarisë dhe, së bashku me propozimet për shpërndarjen e fitimeve, i paraqesin këto dokumente përrpara asamblesë së përgjithshme për miratim;
- të krijoj një sistem paralajmërimi në kohën e duhur për rr Ethanat, që kërcënojnë mbarëvajtjen e veprimtarisë dhe ekzistencën e shoqërisë;



- të kryej regjistrimet dhe dërgojnë të dhënat e detyrueshme të shoqërisë, siç parashikohet në ligjin për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit;
- të kryej detyra të tjera të përcaktuara në ligj dhe në statut.

14.4 Administratori i shoqërisë do të jetë znj. Ada Ilia e ditëlindjes 06.05.1983 me numer dokumenti I35506061B, me një afat 5 vjet me të drejtë ripërtëritje.

NENI 15
Punësimet në shoqëri

15.1 Për punonjësit që do të punësohen në Shoqëri, marrëdhëni e punës midis Shoqërisë dhe këtyre punonjësve, do të rregullohen nëpërmjet kontratës së punës.

15.2 Shoqëria merr përsipër të derdhë në kohën e duhur të gjitha detyrimet ligjore dhe për të punësuarit të bëjë sigurimin e tyre në organet kompetente duke derdhur edhe përqindjen e kontributeve përkatëse sipas dispozitave ligjore në fuqi.

KREU IV
Viti Financiar dhe Bilanci Vjetor, Shpërndarja e Fitimeve

NENI 16
Viti Financiar dhe Bilanci Vjetor

16.1 Viti financiar fillon më 1 janar dhe mbaron më 31 dhjetor.

16.2 Bilanci vjetor, inventari, raporti i seurisë së veprimtarisë dhe raporti i ekspertit kontabël të regjistruar, miratohen nga Asambleja e Përgjithshme (Ortakët e Shoqërisë).

NENI 17
Shpërndarja e Fitimeve

17.1 Ortakët e Shoqërisë kanë të drejtë të marrin pjesën e fitimit të deklaruar në pasqyrat financiare të shoqërisë.

17.2 Shoqëria mund të shpërndajë fitime vetëm nëse pas pagimit të dividendëve:

- aktivet e shoqërisë mbulojnë tërësisht detyrimet e saj;
- shoqëria ka aktive likuide të mjaftueshme për të shlyer detyrimet që bëhen të kërkueshme brenda 12 muajve në vazhdim.

KREU V
Riorganizimi i Shoqërisë, Prishja dhe Likuidimi i Shoqërisë

NENI 18
Riorganizimi i Shoqërisë

18.1 Shoqëria mund të riorganizohet nëpërmjet bashkimit me një shoqëri tjeter, ose nëpërmjet ndarjes në dy apo më shumë shoqëri të tjera ose nëpërmjet shndërrimit të formës ligjore.

18.2 Riorganizimi i shoqërisë mund të bëhet vetëm me vendim të Asamblesë së Përgjithshme.

NENI 19
Prishja dhe Likuidimi i Shoqërisë

19.1 Shoqëria prishet në rastet e parashikuara nga ligji ose me vendim të Asamblesë së Përgjithshme (Ortakët e Shoqërisë).

Në rast prishje shoqëria do t'i nënshtronhet procedurës së likuidimit.

19.2 Për procedurën e likuidimit të Shoqërisë do të aplikohet legjislacioni shqiptar në fuqi.


NENI 20

20.1 Për sa nuk është parashikuar në këtë Statut do të aplikohen dispozitat e Ligjit Nr. 9901, datë 14.04.2008, "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare" (i ndryshuar), Kodit Civil dhe legjislacionit në fuqi në Republikën e Shqipërisë.

Ky Statut hartohet dhe nënshkuhet në 3 (tre) origjinale në gjuhën shqipe, të gjitha me të njëjtën vlerë ligjore. Një origjinal qëndron në dokumentacionin bazë të Shoqërisë.

**ORTAKËT E SHOQËRISË
"ORTECH" SHPK**

ADA ILIA



Tiranë 16.11.2021

MARJOLA XHELILI

